Komuna e Klinës
Kryetari i Komunës
01Nr.023-2949/2026
Klinë, datë 27/01/2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në gazeten zyrtare, me dt. 04.06.2008 nr.28, në nenit 91 paragrafi 1 i Statutit të Komunës së Klinës të dt.07.04.2010, si dhe duke marrë parasysh dispozitat e U.A nr.07/2016 të MTI për Procedurat e Shitjes së Mallrave më Ankand Publik, Kryetari i Komunës së Klinës, mori këtë;

VENDIM

Për formimin e komisionit për zhvillimin e procedurave
për shitjen e mallrave më ankand publik

1. **FORMOHËT,** komisioni komunal për zhvillimin e procedurave për shitjen e mallrave më ankand publik. Përbërja e komisionit është siç vijon;
   1.1. Muhamet Gashi;
   1.2. Astrit Muhaxheri;
   1.3. Anëtari i trete emërohet rast pas rasti.

2. Detyrat e komisionit për zhvillimin e procedurave janë: përgatitja e ftesave për ankand publik, përgatitja e listës së mallrave të cilat do të shiten më ankand dhe çmimin fillestar të tyre të përgatitur nga njësia e logjistikes, përcakton datën, afatin kohor dhe vendin e prezantimit të mallrave para shpalljes së ankandit, pranon ofertat nga ofertuesit të cilëve duhet t'u lëshohet një dokument më rastin e dorëzim-pranimit të ofertave. Të gjithë materialin e pranuar nga ofertuesit përfshire listën e mallrave më çmim fillestar si dhe listën e ofertuesve ja dorëzon komisionit vlerësues.

3. Mandati i komisionit për zhvillimin e procedurave është dy (2) vjeçar, ndërsa anëtari i trete emërohet rast pas rasti varësisht nga lloji i mallrave dhe natyra e ankandit. Anëtaret e komisionit punën e vete e kryejnë në përputhje më autorizimet e dhëna më ketë vendim si dhe Udhëzimin Administrativ te MTI nr.07/2016 për Procedurat e Shitjes së Mallrave më Ankand Publik.

4. Ky vendim është i plotëfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:
- Te përmendurit;
- Ekzekutivi, si dhe;
- Arkivi.

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E KLINËS * MUNICIPALITY OF KLINA * OPŠTINA KLINA * REPUBLIKA KOSOVA

Kryetari,
Zenun Elezaj